

STATUTI I SHOQËRISË “SA4 DEVELOPMENT” shpk

Neni 1 Emri, Forma

Shoqeria do të ketë emrin “SA4 DEVELOPMENT” dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (me poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2 Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Rr.Besim Imami nr.34, kati perdhe njësia administrative nr 10 Tirane .

Neni 3 Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Ndertimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vetë dhe për të tretë. Investimin në projekte zhvillimi zonash urbane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi. Shitja e njësive të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimi të pasurive të paluajtshme apo shitja e projekteve të zhvillimit në veçanti. Administrimi dhe shfrytëzimi i njësive të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimit në zonat e turizmit për qëllime rekreative, restorative dhe akomoduese. Kryerjen e aktivitetit të menaxhimit të riskut dhe shërbimeve këshillimore të sigurisë dhe shëndetit në punë Vlerësim të pasurive të paluajtshme. Administrimin e ambjenteve të përbashketa (në bashkëpunësi) në ndertësat e banimit, objekteve civile etj. Tregtim me pakice e shumice të mallrave të ndryshme të lendeve të para të ndërtimit dhe prodhimeve. Tregtim dhe prodhim të materialeve të ndërtimit. Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudimi si dhe ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale lidhur me fushat përkatëse. Projektme dhe zbatime të ndërtimit civil, industrial, turistik, bujqësor. Projektme dhe zbatime të ndërtimit të brendshëm. Studime, planifikime, vlerësime dhe projektme dhe zbatime urbanistike Projektme dhe zbatime paisazhi dhe sisteme. Studime dhe projektme dhe zbatime produktive; Studime, projektme, dizajnime dhe zbatime për treg. Studime, projektme dhe zbatime të inxhinierisë së ndërtimit, inxhinierisë elektrike dhe inxhinierisë hidromekanike. Projektme konstruktive dhe supervizim punimesh Studime e projektme dhe zbatime hidrogeologjike dhe gjeologjike; Projektim dhe zbatime fotogrametrik, hartografik, topografik; Studime fizibiliteti; Projektme dhe zbatime rrugësh, urash, porte turistike; Projektme dhe zbatime linjash dhe sistemesh të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projektim ujësjelles, kanalizime, vepra ujë, kullimi, impiante vaditëse, diga, etj; Restaurime dhe konsulencë për shërbimet e mësipërme; Tregtim mallrash brenda dhe jashtë vendit; Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100.000 Leke, i ndarë në një kuote, i cili zotërohet si më poshtë:

Z. Klaudio Cari, zotëron 1 kuotë me vlerë 34.000 Leke (tridhjetëkater mijë Leke), e cila përbën 34 % të kapitalit të shoqërisë

Z. Lorin Çekrezi, zotëron 1 kuotë me vlerë 33.000 Leke (tridhjetetë mijë Leke), e cila përbën 33 % të kapitalit të shoqërisë

Z.Rezart Struga, zotëron 1 kuotë me vlerë 33.000 Leke (tridhjetetë mijë Leke), e cila përbën 33 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve është në para

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara

Neni 6
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 7
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8 Mënyra e thirrjes

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë

Neni 9 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 60 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 10 të Statutit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin

rend dite.

Neni 10
Marrja e vendimeve

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 9 të këtij statuti, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 7 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 11
Administrimi

Administratorë i shoqërisë është:

Z. Klaudio Cari shtetas shqiptar lindur 14.10.1987 lindur në Tirane dhe banues në Tirane, mbajtes i Letërnjoftimit ID, me numër personal I71014034C, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e ortakëve emëron dhe shkarkon Administratorin e shoqërisë me shumicë të zakonshme. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët i ushtrojnë kompetencat bashkë ose veç e veç.

Neni 12
Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto



dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Shoqëria prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne rastin e pikës b) Asambleja e Ortakëve merr vendim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Neni 16

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Neni 17
Riorganizimi (bashkimi, ndarja, shndërrimi)

Riorganizimi i shoqërisë (bashkim, ndarje, shndërrim) do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Neni 18
Baza Ligjore

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të treteve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 20
Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Klaudjo Cari 

Tirane 01/09/2025

Rezart Struga 

Corin Gervazi 